



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VI  
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit  
SP-029  
Prishtinë, më 3 maj, 1 dhe 4 qershor 2018

**PROCESVERBAL**

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 3 MAJ, 1 DHE 4 QERSHOR 2018**

Seancën e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga Xhavit Haliti dhe Kujtim Shala, nënkryetarë të Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 19 prill 2018.

**1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës**

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti, Anton Çuni, Rexhep Selimi, Dardan Molliqaj, Teuta Haxhiu, Milaim Zeka dhe Slobodan Petroviq, si dhe kryeministri Ramush Haradinaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

## **2. Koha për pyetje parlamentare**

Deputeti Slobodan Petroviq i parashtrroi pyetje kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në lidhje me hetimin e Prokurorisë Speciale të Kosovës për rastin e vrasjes së Oliver Ivanoviqit.

Kryeministri Ramush Haradinaj iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Zafir Berisha i parashtrroi pyetje ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Nenad Rikalo, në lidhje me procedimin për në Kuvend të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyjet.

Kryeministri Ramush Haradinaj iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Ismajl Kurteshi i parashtrroi pyetje kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në lidhje me veprimet e ndërmarra nga Qeveria që qytetarët e pjesës veriore të Kosovës ta paguajnë energjinë elektrike të shpenzuar.

Kryeministri Ramush Haradinaj iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Driton Selmanaj i parashtrroi pyetje kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, nëse ai është i informuar që presidenti i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, po negocion me presidentin e Serbisë, z. Aleksandër Vuçiq, për çështjen e veriut dhe shkëmbimin e territoreve, si dhe për rezolutën e miratuar në Kuvendin e Kosovës në vitin 2012 për procesin e bisedimeve me Serbinë.

Kryeministri Ramush Haradinaj iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Driton Selmanaj i parashtrroi pyetje ministrit të Financave, Bedri Hamza, në lidhje me veprimet e Ministrisë së Financave për zbatim të nenit 80 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, që ka të bëjë me kompensimet shtesë të nëpunësve civilë për pjesëmarrje në komisione të ndryshme.

Ministri Bedri Hamza iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Albulena Haxhiu i parashtrroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, në lidhje me mospagesën e infermierëve për punën gjatë ditëve të vikendeve në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Ministri Uran Ismaili nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja Albulena Haxhiu i parashtrroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj, në lidhje me emërimin e Nexhat Krasniqit në pozitën e drejtorit të prokurimit në Ministrinë e Infrastrukturës.

Ministri Pal Lekaj nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja Besa Baftiu i parashtrroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, në lidhje me veprimet e ndërmarra nga Ministria e Shëndetësisë që institucionet shëndetësore publike të lëshojnë certifikatat mjekësore për kandidatët për patentë shoferë.

Ministri Uran Ismaili nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja Mimoza Kusari-Lila i parashtrroi pyetje ministrit të Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, në lidhje me një deklaram të ministrit z. Hasani të dhënë në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, për znj. Lila gjatë kohës sa ajo ishte ministre e asaj ministrie.

Ministri Bajram Hasani nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti Adem Mikullovc i parashtrroi pyetje kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në lidhje me planifikimet e Qeverisë së Republikë së Kosovës për ta paditur Serbinë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me dëmet e luftës. Kryeministri Ramush Haradinaj iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Ismajl Kurteshi i parashtrroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në lidhje me veprimet e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për zbatim e marrëveshjes së lidhur ndërmjet kësaj ministri me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve, në lidhje me vlerësimin e kualifikimeve dhe akreditimin e të gjitha institucioneve të arsimit dhe aftësimin profesional.

Ministri Shyqiri Bytyqi iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Time Kadrijaj i parashtrroi pyetje kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në lidhje me veprimet e Qeverisë së Republikë së Kosovës për krijimin e komisionit për korrigjimin e gabimeve në shënjimin e vijës kufitare në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.

Kryeministri Ramush Haradinaj iu përgjigj pyetjes së deputetes.

### **3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se seancat e mbajtura më 16, 20 dhe 27 prill 2018 nuk kanë përfunduar, andaj procesverbalet e këtyre seancave do të procedohen për miratim pas përfundimit të seancave.

\* \* \*

Në vazhdim deputeti Daut Haradinaj, në cilësinë e propozuesit të projektligjit, i propozoi Kuvendit që pika e gjashtë e rendit të ditës: Shqyrtimi i parë i Projektligjit për amnistinë të shtyhet për një seancë tjetër.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e deputetit Daut Haradinaj.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për ----- 65,  
Kundër ----- 0,  
Abstenime ----- 7.

Kuvendi e miratoi propozimin e deputetit Daut Haradinaj për ta shtyrë shqyrtimin e Projektligjit për amnistinë për një seancë tjetër.

#### **4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-062 për ratifikimin e traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për ekstradim**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se në mungesë të kuorumit, shqyrtimi i kësaj pike shtyhet për më vonë.

#### **5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar Projektligjin për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe Kuvendit i ka rekomanduar mosmiratimin e tij.

Ai e ftoi ministrin e Drejtësisë që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit si dhe i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve diskutuan deputetët: Albulena Haxhiu, në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe në emër të GP të LVV-së; Korab Sejdiu, në emër të GP të LDK-së; Hajdar Beqa, në emër të GP të PDK-së; Frashër Krasniqi, në emër të GP Deputetët e Pavarur; Shkumbin Demaliaj, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP Nisma; Bahrim Shabani, në emër të GP “6+”, Sami Kurteshi, Vjosa Osmani, Milaim Zeka dhe ministri Abelard Tahiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 56,  
Kundër ----- 30,  
Abstenime ----- 0.

Kuvendi mori këtë:

#### **V E N D I M**

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

2. Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

## **7. Emërimi i drejtorit dhe i zëvendës drejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë dhe Kuvendit i ka rekomanduar mosemërimin e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

Ai propozoi që votimi i fshehtë të bëhet përnjëherë me kandidatët për drejtor dhe zëvendës drejtor të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

Kuvendi e miratoi propozimin e kryesuesit.

Kryetarja e Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsion, Albulena Haxhiu, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Pastaj, kryesuesi kërkoi nga grupet parlamentare që ta propozojnë nga një anëtar në Komisionin votues për të zhvilluar procedurat e votimit të fshehtë.

Me propozimin e grupeve parlamentare, Kuvendi e zgjodhi Komisionin votues në këtë përbërje:

Fidan Rekalju, GP LDK,  
Luljeta Veselaj-Gutaj, GP PDK,  
Salih Zyba, GP LVV,  
Driton Çausi, GP Deputetët e Pavarur,  
Teuta Haxhiu, GP AAK,  
Adem Hoxha, GP Lista serbe,  
Enver Hoti, GP Nisma dhe  
Bahrim Shabani, GP 6+.

Në vazhdim, kryesuesi i ftoi anëtarët e Komisionit votues që të fillojnë procedurat e votimit të fshehtë për përzgjedhjen e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, si dhe i ftoi deputetët një nga një që të votojnë.

Pas zhvillimit të procedurës së votimit të fshehtë, në emër të Komisionit votues rezultatin e votimit për emërimin e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të

Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës e paraqiti deputetja Luljeta Veselaj-Gutaj.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

- në votim kanë marrë pjesë 98 deputetë;
- të pavlefshme janë 9 fletëvotime;
- votat e fituara për kandidatët e propozuara për drejtor të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës:

1. Florie Kika i ka fituar 40 vota dhe
2. Naser Shala i ka fituar 46 vota.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar për emërimin e zëvendës drejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës:

1. Milaim Çekaj i ka fituar 47 vota dhe
2. Mark Buzhala i ka fituar 35 vota.

Kryesuesi konstatoi se asnjë nga kandidatët nuk i ka fituar votat e mjaftueshme për t'u zgjedhur drejtor dhe zëvendës drejtor të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës. Prandaj, duhet përsëritur konkursi për këto pozita.

## **8. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 19 prill 2018 ka kërkuar nga grupet parlamentare të Kuvendit që të propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar.

Pastaj ai i ftoi kryetarët e grupeve parlamentare që të propozojnë deputetët për formimin e këtij komisioni.

Kryesuesi i hodhi në votim propozimet e grupeve parlamentare për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 66,  
Kundër ----- 0,  
Abstenime ----- 2.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

## V E N D I M

I. Formohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar, në këtë përbërje:

1. .... nga GP i LS-së, kryetar,
2. Nait Hasani,..... nga GP i PDK-së, zv. kryetar i parë,
3. Valon Ramadani,..... nga GP i LVV-së, zv. kryetar i dytë,
4. Armend Zemaj,..... nga GP i LDK-së, anëtar,
5. Doruntinë Maloku, ... nga GP i LDK-së, anëtar,
6. Mërgim Lushtaku,..... nga GP i PDK-së, anëtar,
7. Adem Mikullovc, .... nga GP i LVV-së, anëtar,
8. Shqipe Pantina, ..... nga GP Deputetët e Pavarur, anëtare,
9. Rasim Selmanaj, ..... nga GP i AAK-së anëtar,
10. Milaim Zeka,..... nga GP Nisma, anëtar dhe
11. Albert Kinolli, ..... nga GP “6+”, anëtar.

II. Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar duhet të veprojë në përputhje me nenin 26, paragrafi 2.3 të Ligjit nr. 04/L-046 për Radio Televizionin e Kosovës dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

Kryesuesi konstatoi se Grupi Parlamentar Lista serbe nuk e ka dhënë propozimin e vet për kryetar dhe sipas rregullave për formimin e komisioneve ad hoc, komisionin do ta kryesojë zëvendëskryetari i parë.

### **9. Propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për shkarkimin e nënkryetares së Kuvendit, znj. Aida Dërguti**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm kjo pikë e rendit të ditës nuk do të shqyrtohet.

### **10. Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, mbështetur nga 41 deputetë nënshkrues, në bazë të nenit 4, paragrafi 1 të Ligjit për hetim parlamentar i ka propozuar Kuvendit formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës.

Ai e ftoi kryetarin e Grupit Parlamentar të LDK-së ta paraqesë propozimin për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar.

Kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, Avdullah Hoti, e paraqiti dhe e arsyetoi propozimin për formimin e këtij komisioni. Diskutimi i tij i plotë është dhënë në transkript.

Lidhur me formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar diskutuan deputetët: Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së; Dardan Molliqaj, në emër të GP të PSD-së; Teuta Haxhiu, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të NISMA-s; Albert Kinolli, në emër të GP “6+”, Muharrem Nitaj, Fatmir Xhelili, Ilir Deda, Safete Hadërgjonaj, Arbër Rexhaj, Vjosa Osmani, Milaim Zeka, Naser Rugova, Kujtim Shala, Avdullah Hoti dhe Driton Selmanaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Grupet parlamentare të LDK-së, LVV-së, PSD-së, AAK-së, NISMA-s dhe “6+” i propozuan deputetët për anëtarë të këtij komisioni, ndërsa grupet parlamentare të PDK-së dhe Listës serbe nuk i dhanë propozimet për anëtarë të këtij komisioni.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi tha se në mungesë të propozimeve nga dy grupe parlamentare, formimi i këtij komisioni shtyhet.

Kryesuesi i ndërpreu punimet e seancës plenare në orën 17:25 minuta dhe për vazhdimin e pikave të papërfunduara do të vendosë Kryesia e Kuvendit.

\* \* \*

***E premte, më 1 qershor 2018***

***Vazhdimi i seancës plenare***

Vazhdimin e seancës plenare e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga Xhavit Haliti dhe Kujtim Shala, nënkryetarë të Kuvendit.

Kuvendi i shqyrtoi pikat e papërfunduara të rendit të ditës, si në vijim:

***4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-062 për ratifikimin e traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për ekstradim***

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Pastaj ai e ftoi ministrin e Drejtësisë ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit, si dhe i ftoi deputetët që ta miratojnë.

Kryesuesi tha se në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, votimi i këtij projektligji shtyhet.



**9. Propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për shkarkimin e nënkryetares së Kuvendit, znj. Aida Dërguti**

Kryetari i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar Lëvizjes Vetëvendosje ka paraqitur propozimin për shkarkimin e nënkryetares së Kuvendit, znj. Aida Dërguti.

Ai e ftoi kryetarin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje ta paraqesë dhe ta arsyetojë propozimin.

Kryetari i GP të LVV-së, z. Glauk Konjufca, e paraqiti dhe e arsyetoi propozimin për shkarkimin e nënkryetares së Kuvendit, znj. Aida Dërguti.

Lidhur me propozimin e lartshënuar diskutuan deputetët: Dardan Molliqaj në emër të GP të PSD-së, Milaim Zeka, Sami Kurteshi, Dardan Sejdiu, Salih Zyba, Adem Mikullovc, Memli Krasniqi, Armend Zemaj, Bilall Sherifi dhe Islam Pacolli, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryetari tha se në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, votimi i këtij propozimi shtyhet.

**10. Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës**

Kryetari tha se shumica e grupeve parlamentare i kanë propozuar deputetët për anëtarë të këtij komisioni, ndërsa GP i PDK-së dhe GP i Listës serbe nuk i kanë dhënë propozimet.

Për fjalë u paraqit kryetari i GP të PDK-së, z. Memli Krasniqi, i cili deklaroi se Kuvendi mund të vazhdojë me formimin e komisionit, por grupi ynë i dërgon ndërkohë emrat e deputetëve për anëtarë të këtij komisioni.

Në vazhdim kryetari i GP të PSD-së, z. Dardan Sejdiu, e propozoi deputeten Shqipe Pantina për anëtare të këtij komisioni.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim formimin e komisionit të lartshënuar.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 66,  
Kundër ----- 2,  
Abstenime ----- 3.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

## V E N D I M

Për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga ana e Presidencës dhe Qeverisë të Republikës së Kosovës.

I. Formohet Komisionit Hetimor Parlamentar, me përbërje si në vijim:

1. Dardan Sejdiu, ..... nga GP i PSD-së, kryesues,
2. Lumir Abdixhiku, ..... nga GP i LDK-së, zëvendëskryesues,
3. Vjosa Osmani, ..... nga GP i LDK-së, anëtare,
4. Ilir Deda, ..... nga GP i LDK-së, anëtar,
5. Safete Hadërgjonaj, ..... nga GP i PDK-së, anëtare,
6. Mërgim Lushtaku, ..... nga GP i PDK-së, anëtar,
7. Hajdar Beqa, ..... nga GP i PDK-së, anëtar,
8. Arbërie Nagavci, ..... nga GP i LVV-së, anëtare,
9. Drita Millaku, ..... nga GP i LVV-së, anëtare,
10. Shqipe Pantina, ..... nga GP i PSD-së, anëtare,
11. Muharrem Nitaj, ..... nga GP i AAK-së, anëtar,
12. Blerim Kuçi, ..... nga GP i AAK-së, anëtar,
13. .... nga GP Lista serbe, anëtar
14. Zafir Berisha, ..... nga GP NISMA, anëtar dhe
15. Fikrim Damka, ..... nga GP "6+"

II. Mandati i anëtarëve të Komisionit Hetimor Parlamentar, sipas pikës (I) të këtij vendimi, është 1 (një) muaj.

Kryesuesi i ndërpreu punimet e kësaj seance në orën 17:30.

\* \* \*

*E hënë, më 4 qershor 2018*

*Vazhdimi i seancës plenare*

***4. Votimi i Projektligjit nr. 06/L-062 për ratifikimin e traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për ekstradim***

Kryesuesi i njoftoi deputetët se diskutimet për këtë projektligj kanë përfunduar në vazhdimin e seancën plenare të mbajtur më 1 qershor 2018.

Pastaj, ai e hodhi në votim Projektligjit nr. 06/L-062 për ratifikimin e traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për ekstradim.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 83,  
Kundër ----- 0,  
Abstenime ----- 1.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

## V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-062 për ratifikimin e traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për ekstradim.

### ***9. Votimi i Propozimit të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për shkarkimin e nënkryetares së Kuvendit, znj. Aida Dërguti***

Kryesuesi i njoftoi deputetët se diskutimet për këtë propozim kanë përfunduar në vazhdimin e seancën plenare të mbajtur më 1 qershor 2018.

Ai e hodhi në votim propozimin e lartshënuar.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 17,  
Kundër ----- 26,  
Abstenime ----- 48.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

## V E N D I M

Nuk miratohet propozimi për shkarkimin e nënkryetares së Kuvendit, znj. Aida Dërguti.

Kryetari i mbylli punimet e seancës plenare më 4 qershor, në orën 11:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit:  
Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:  
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*